



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 180/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, dhe e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Miratohet në tërësi ankesa Anr.180/2012, e datës 16.06.2012, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Kaçanik, ndërsa ankesa Anr.182/2012, e datës 17.06.2012, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) miratohet pjesërisht, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2050 (dymijë e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 16.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 16.06. 2012, në Kaçanik rreth orës 10:00, militantë të subjektit politik të AAK-së, kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre, për kryetar komune, Tahir Çaka, tek “ish moteli”, që sipas pretenduesit të ankesës është pronë shoqërore, mbi kalanë që është monument kulturor dhe që ndodhet në rrugën ”Agim Bajrami”. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, neni 3.1 pika (b), si dhe të nenit 33.1 pika (b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 17.06.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik AAK, ka shkelur Rregullat Zgjedhore duke vendosur postera, billborde, në objekte të ndaluara, si në kalanë e Komunës, po ashtu sipas pretenduesit në ankesë këta posterë janë vendosur edhe afër qendrës së votimit të shkollës “Skenderbeu”, në Kaçanik, ku sipas parashtruesit në ankesë, kjo ka ndodhur në orën 18:00 datë 16.06.2012.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, më datë 16.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës Anr. 180/2012 deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr. 180/2, PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë brenda afatit të caktuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se: Ankesa është e pa qartë, ngase parashtruesi i ankesës nuk ka cekur emërtimin e institucionit dhe se çfarë statusi juridik ka ky institucion, po ashtu në përgjigjen në ankesë subjekti politik AAK, thekson se parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar fakte nëse këto hapësira janë objekte publike, nuk ka tabela njoftuese dhe gjithashtu në përgjigjen në ankesë thuhet se në po të njëjtat objekte kanë qenë edhe materiale tjera dhe afishe që janë të lexueshme.

Po ashtu PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK, më datë 17.06.2012, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës Anr. 182/2012 deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr. 182/2, PZAP-i, mori përgjigjen në ankesë brenda afatit të caktuar nga subjekti politik AAK, i cili thotë se sa i përket ankesës në fjalë rreth shkeljeve të mundshme, konsiderojmë se fotografia nr.3 është e pa qartë, ngase parashtruesi i ankesës këtë e ka bërë për të mjegulluar materialet të cilat sipas AAK-së, janë materiale edhe të subjekteve tjerë. Gjithashtu subjekti politik AAK, në përgjigjen në ankesë thekson se sa i përket fotografisë me nr.4, nuk është ofruar dëshmi se aty ka ndonjë institucion publik, përveç urës lumit dhe një objekti kolektiv banimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë në ankesën Anr. 180/2012 e datës 16.06.2012, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, shihet se posteri i kandidatit për kryetar të komunës së Kaçanikut, Tahir Çaka, nga radhët e subjektit politik AAK, është i vendosur mbi kalanë e qytetit, si dhe po ashtu e njëjta fotografi me nr.3 në ankesën Anr. 182/2012 shihet se i njëjti poster është i vendosur në po të njëjtin vend. PZAP-i, veprimin e sipërshënuar e konstaton si veprim të ndaluar e që bie në kundërshtim me nenin 3.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së i cili përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore.

Ndërsa sa i përket fotografisë me nr.1 dhe me nr.2 të cilat gjenden në ankesën Anr.182/2012 e datës 17.06.2012, PZAP-i, ka konstatuar se është çështje e gjykuar, me vendimin e marrë nga PZAP-i, Anr. 169/2012 e datës 14.06.2012, andaj edhe nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e këtyre provave.

Nga fotografia me nr.4 e cila gjendet në ankesën Anr. 182/2012 e datës 17.06.2012, PZAP ka konstatuar se kjo dëshmi nuk është e asaj natyre që do të mund të vërtetohet se a është me afër se 100 metra Qendra e Votimit siç pretendon pala ankuese.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Prandaj PZAP, duke marrë parasysh se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 3 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe neni 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet se posteritë e kandidatit për kryetar të Komunës së Kaçanikut nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në objekt publik, (kala) e po ashtu subjekti i njëjtë politik ka përsëritë shkeljen e *Kodit të Mirësjelljes për subjektet politik Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, PZAP, këtë e ka marrë si rrethanë rënduese për rritjen e gjobës së shqiptuar. Nga të gjitha arsyet e lartshënuara e si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 180/2012 më datën 18.06.2012.

